Universiteti i Tiranës

Fakulteti Ekonomik

Departamenti i Financës

KONKURS MBI PUNËT KËRKIMORE 2

JSTOR

FUSHA E APLIKIMIT: Edukimi dhe punësimi

Faktorët që ndikojnë integrimin në tregun e punës të grave shqiptare: Roli i Edukimit

Punoi: Kristjana Bardho

Informatikë ekonomike, Viti I

Tiranë, 2021

1.Hyrje

Ngushtimi i hendekut të papunësisë dhe rritja e pjesëmarrjes së grave në tregun e punës mbetet një sfidë e qenësishme. Studime të gjithanshme që tregojnë vendin që zënë gratë në tregun e punës, sfidat që ato ndeshin përfshirë diferencimet në paga krahasuar me burrat, kontributin e tyre në prodhimin bruto vendas dhe përdorimin e kohës janë të rëndësishme për hartimin e politikave që nxisin pjesëmarrjen e grave në tregun e punës (Dang, H.H.& Nguyen, C.V. 2020).

Diferencat e pagës midis grave dhe burrave zakonisht shpjegohen nga akumulimi i ndryshëm i kapitalit njerëzor, pavarësisht nga pozicioni hierarkik. Gratë janë të orientuara drejt familjes dhe kjo rezulton në një kufizim të disponueshmërisë së tyre profesionale në kohë duke çuar në një disavantazh të pagës për gratë me një familje. Sipas sondazheve të sektorit publik dhe privat shqiptar, gratë, përfshirë ato në pozicione më të larta, kanë tendencë të punojnë në nivele më të ulëta hierarkike sesa burrat (Norton, S. W., & Tomal, A. (2009).

Pjesëmarrja e grave në tregun e punës ka një rëndësi të madhe për shkak të rritjes së të ardhurave familjare, reduktimit të varfërisë dhe rritjes ekonomike në përgjithësi. Megjithatë pavarësisht kësaj ato kanë hasur dhe vazhdojnë të hasin barriera të shumta, ndërsa tentojnë të përfshihen në forcën punëtore (Cotter, D. A., Hermsen, J. M., & Vanneman, R. 2001).

Ky studim zbulon shkallën reale në të cilën gratë janë në disavantazh në tregun e punës, duke përdorur të dhëna të grumbulluara nga 150 gra të punësuara dhe të papunësuara nga zona të ndryshme në Shqipëri. Rezultatet kanë treguar se më shpesh normat e ulëta të fuqisë punëtore të grave tregojnë stereotipe të forta kulturore në lidhje me rolet gjinore, të cilat i mbajnë gratë jashtë fuqisë punëtore. Përpjekjet për të rritur normat e pjesëmarrjes së grave në tregun e punës duhet të marrin parasysh boshllëqet gjinore dhe njëkohësisht të kërkojnë më shumë ekuilibër në orët e shpenzuara për punë riprodhuese nga burra dhe gra.

1.1 Qëllimi i punimit:

Qëllimi i këtij studimi është të analizojë faktorët socio-ekonomik që pengojnë integrimin e grave shqiptare të moshës 18-45 vjeçare në tregun e punës si dhe të evidentojë nëse edukimi rrit shancet për tu punësuar.

Pyetjet dhe hipoteza e hulumtimit

➢ Cilat janë barrierat që hasin gratë Shqiptare gjatë përpjekjeve për tu integruar në tregun e punës?

➢ Si ndikon niveli arsimor pjesëmarrjen e grave Shqiptare në tregun e punës?

Hipoteza 1: Normat sociale kanë një ndikim negativ të rëndësishëm mbi pjesëmarrjen e grave në tregun e punës.

Hipoteza 2: Stereotipizimi gjinor ka një ndikim negativ të rëndësishëm në pjesëmarrjen e grave në tregun e punës.

2. Zhvillimi

2.1 Rishikimi i literaturës

Pjesëmarrja e grave në aktivitetet e tregut të punës duket se ndikohet nga faktorë të tillë si mosha, statusi martesor, feja, etnia etj. Por theksi në literaturë është që arsimi është një përcaktues kryesor i pjesëmarrjes së grave në tregun e punës. Shumë studiues raportojnë se ekziston një marrëdhënie pozitive midis arsimimit dhe probabilitetit të përfshirjes në punë me pagesë midis grave (Finegan, 1975).

Për shembull, Finegan raporton mbi studimin e tij duke përdorur një shembull të regjistrimit të vitit 1960 që norma e rregulluar e pjesëmarrjes në forcën e punës të grave të martuara "rritet në mënyrë të vazhdueshme nga rreth 20 përqind për gratë me më pak se pesë vjet shkollim në 35% për ato me një shkollë të mesme në 47% për ato me një diploma universitare dhe në fund në 61% për ato që ndjekin arsimin pasuniversitar".

Në një studim mbi rolin e edukimit në punësimin e grave në Nigerinë rurale është vënë re se niveli arsimor i grave është një nga faktorët kryesorë që përcaktojnë pjesëmarrjen e grave në tregun e punës (Adeyem, O. E., Odusina, K. E., & Akintoye, A. E. (2016). Studimi arrin në përfundimin se mosha, statusi martesor, madhësia e familjes janë disa nga faktorët që ndikojnë pozitivisht dhe në mënyrë të konsiderueshme pjesëmarrjen e grave në tregun e punës, ndërsa, gjendja shëndetësore, pronësia e tokës janë disa nga faktorët që zvogëlojnë pjesëmarrjen e e

grave në treg e punës. Studimi konkludon sesa më i lartë niveli i arsimit, aq më të larta janë gjasat e pjesëmarrjes së grave në aktivitetet e tregut të punës (Hadjar, A., & Buchmann, C. (2016).

Ndër shumë studimeve që identifikojnë një marrëdhënie të drejtë pozitive midis rritjes së nivelit arsimor dhe pjesëmarrjen së grave në tregun e punë evidentohen dhe rezultate të ndryshme. Kështu për shembull Verick, S 2014 në një studim mbi pjesëmarrjen e grave në tregun e punës në vendet e zhvilluara pohon se në shumë vende ekziston një marrëdhënie jolineare (herë pas here, në formë U) midis arritjeve arsimore dhe pjesëmarrjes

së grave në fuqinë punëtore.

Gratë më të pashkolluara në vendet e varfëra kanë më shumë gjasa të marrin pjesë në aktivitete jetësore dhe në punë informale, ndërsa gratë me arsim të mesëm të lartë mund të kenë mundësi të qëndrojnë jashtë fuqisë punëtore. Sapo gratë të kenë më shumë se një shkollë të mesme, pagat më të larta i inkurajojnë të bashkohen me fuqinë punëtore, veçanërisht nëse ekzistojnë punë të përshtatshme (Lincove, J. A. (2008).

Për më tepër, është provuar empirikisht se kthimi nga investimet arsimore të grave është shumë më i lartë sesa i burrave. Kjo nënkupton që gratë duhet të kenë një nxitje më të lartë për të investuar në arsim sesa burrat. Studime ekonomike tregojnë se të ardhurat nuk janë aspekti i vetëm i prekshëm nga arsimimi i grave. Nga një këndvështrim neoklasik ,arsimi

ndikon në shkallën e lindshmërisë së grave, e shpjeguar me arsyetimin se ndërsa investimet në kapitalin njerëzor rriten dhe sa më shumë gra marrin pjesë në tregun e punës, ka të ngjarë të ndryshojë shkalla e lindshmërisë, në favor të lindjes së më pak fëmijëve.

Göksel, İdil (2013) ofron një përqasje interesante të barrierave që hasin gratë Turke në integrimin në tregun e punës. Sipas autores në Turqi evidentohet se ndërsa niveli i arsimimit të grave është në rritje, niveli i fertilitetit dhe ai i punësimit është në zbritje. Kjo tregon se nuk është niveli i edukimit dhe fertilitetit që ndikojnë punësimin e grave më tepër sesa faktorë të tjerë që studiuesja i ka emërtuar si faktorë konservatorë të tillë si feja dhe normat sociale. Në këtë studim pretendohet se vendimi i grave për të marrë pjesë në tregun e punës varet nga faktorë të tillë si normat shoqërore, leja e burrave, përgjegjësitë e kujdesit për fëmijët dhe faktorë ligjorë dhe institucionalë (Gumus, S. (2014).

Studimi i kryer nga Hosney, Sara Hassan mbi faktorët që influenconin pjesëmarrjen e grave në Egjipt, në një këndvështrim krahasues me Gjermaninë (2016) tregon se lidhur me ndikimin e arsimit në shkallën e pjesëmarrjes së femrave egjiptiane, rezultatet sugjerojnë që nëse dëshirohet një pjesëmarrje më e lartë e femrave në tregun e punës, atëherë femrat ose duhet të shkojnë në shkollë të mesme të përgjithshme dhe më pas të ndjekin arsimin universitar ose të shkojnë në shkollën e mesme profesionale për të hyrë drejtpërdrejtë në tregun e punës.

Analiza e mëtejshme e karakteristikave të tjera personale dhe shtëpiake tregonte se një numër faktorësh ndikojnë në pjesëmarrjen e grave egjiptiane në tregun e punës, disa prej të cilëve kanë një ndikim pozitiv si të qenit beqar, të jetuarit në një zone rurale, pasja e një përvoje të mëparshme të punës etj (Jayachandran, S. 2015).

2.2 Metodologjia

Kërkimi empirik është shtrir në disa qytete të Shqipërisë duke përfshirë Tiranën, Durrësin, Fierin, Vlorën dhe qytete të tjera të vendit. Qasja metodologjike që do të përdoret është ajo sasiore. Metoda e kërkimit sasior është një kërkim në problemet sociale dhe humane, bazuar në testimin e një teorie e përbërë nga variabla, e matur me numra dhe analizuar me procedura statistikore, në mënyrë për të përcaktuar nëse teoria parashikuese mund të përgjithësohen (Jick, T. D. (1979).Në kërkimin sasior qëllimi është, zakonisht, për të testuar teoritë nëpërmjet metodës deduktive, duke kërkuar dëshmi që mbështesin apo hedhin poshtë hipotezën (Johnson, R. B., & Onwuegbuzie, A. J. (2004).

Popullata dhe kampioni: Popullata e këtij studimi është e përbërë nga të gjitha gratë punëkërkuese në qytete të ndryshme të vendit. Nga kjo populatë janë përzgjedhur 150 gra përmes kampionit të volitshëm, lloj kampionimi jo probabilitar, i cili është me komod dhe i drejtëpërdrejtë.

Për të siguruar të dhënat primare do të përdoret instrumenti i pyetësorit i përbërë nga disa pohime me Shkallën Likert me 5 (pesë) shkallë.Të dhënat do të mblidhen përmes një pyetësori

të bazuar në internet. Një sondazh në internet ka avantazhin e arritjes së një audience të madhe me shpejtësi me koston e krijimit të biaseve ndaj atyre që kanë qasje në platformën online.

Rezultatet e pritshme të hulumtimit

Në shoqërinë shqiptare me orientim ende të fuqishëm maskilist, me doza të forta të mentalitetit tradicional, kultura që legjitimon pushtetin e burrave vazhdon të mbijetojë dhe prodhojë steriotipet gjinore, diskriminimin dhe pabarazitë me gjininë tjetër. Ekzistojnë disa lloje të barrierave që bllokojnë gratë nga rritja në pozicionet më të larta në fushën e punësimit. Si rezultat pres një konfirmim të hipotezave të ngritura dhe konkretisht:

H 1: Normat sociale kanë një ndikim negativ të rëndësishëm mbi pjesëmarrjen e grave në tregun e punës.

H2: Stereotipizimi gjinor ka një ndikim negativ të rëndësishëm në pjesëmarrjen e grave në tregun e punës.

2.3 Analiza

3.1 Identifikimi i barrierave kryesore në integrimin e grave në tregun e punës

Për të identifikuar disa prej barrierave kryesore që gratë pjesëmarrëse në studim ndeshën për tu integruar në tregun e punës janë treguar marëdhëniet midis variablave me anë të tabeles krosstabulare. (Figura 3.1).

7.Statusi juaj i punësimit * 9.Cili është shkaku kryesor i papunësisë suaj Crosstabulation

			9.Cili është shkaku kryesor i papunësisë suaj							Total
			Nuk kam mundur te gjej pune	Nuk dua te punoj	E kam te veshtire te kombinoj punen me punet e shtepise	Diskriminimi	Pandemia Globale	Tjeter	6	
7.Statusi juaj i punësimit	Punoj ne sektorin publik	Count	2	0	0	0	0	1	0	3
		% of Total	2.7%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	1.4%	0.0%	4.1%
	Punoj ne sektorin privat	Count	3	0	1	1	1	1	1	8
		% of Total	4.1%	0.0%	1.4%	1.4%	1.4%	1.4%	1.4%	11.0%
	Jam e vetpunsuar	Count	1	0	0	1	0	0	1	3
		% of Total	1.4%	0.0%	0.0%	1.4%	0.0%	0.0%	1.4%	4.1%
	E papune	Count	32	1	3	8	0	4	11	59
		% of Total	43.8%	1.4%	4.1%	11.0%	0.0%	5.5%	15.1%	80.8%
Total		Count	38	1	4	10	1	6	13	73
		% of Total	52.1%	1.4%	5.5%	13.7%	1.4%	8.2%	17.8%	100.0%

Fig3.1

Rezultatet tregojnë se barriera kryesore e integrimit të grave në tregun e punës është Mungesa e vendeve të punës (43.8%), ndërsa arsye të tjera janë Diskriminimi (11%) dhe Vështirësia për të kombinuar punët e shtëpisë me punën (4.1%).

3.2 Ndikimi i nivelit arsimor në Integrimin e Grave në tregun e punës

Për të identifikuar marëdhënien që ekziston midis nivelit arsimor të grave pjesëmarrësve dhe statusit të punësimit është ndërrmarë tabela krosstabulare e mëposhtme:

Crosstab

			3.Niveli arsimor							Total
			Pa arsim	Shkolle fillore	Shkolle 9vjecare	Shkolle e mesme	Universitet	Master	Doktorature	
7.Statusi juaj i punësimit	Punoj ne sektorin publik	Count	0	0	1	1	4	8	3	17
		% of Total	0.0%	0.0%	0.7%	0.7%	2.7%	5.4%	2.0%	11.5%
	Punoj ne sektorin privat	Count	4	0	0	8	17	28	0	57
		% of Total	2.7%	0.0%	0.0%	5.4%	11.5%	18.9%	0.0%	38.5%
	Jam e vetpunsuar	Count	0	0	0	5	4	6	0	15
		% of Total	0.0%	0.0%	0.0%	3.4%	2.7%	4.1%	0.0%	10.1%
	E papune	Count	5	3	1	22	15	13	0	59
		% of Total	3.4%	2.0%	0.7%	14.9%	10.1%	8.8%	0.0%	39.9%
Total		Count	9	3	2	36	40	55	3	148
		% of Total	6.1%	2.0%	1.4%	24.3%	27.0%	37.2%	2.0%	100.0%

Tabela 3.2

Sipas tabelës vihet re 8/17 pjesëmarrës punojnë në sektorin publik dhe janë me nivel arsimor Master, 28/57 punojnë në sektorin privat dhe janë me nivel arsimor Master, 6/15 janë të vetpunësuara dhe me nivel arsimor Master dhe 22/39 janë të papuna me Shkollë të Mesme. Për të njëjtin grup variablash është parë dhe Pearson Chi-square test, i cili tregon nëse midis dy variablave ka një marrëdhënie të rëndësishme statistikore.

Chi-Square Tests

	Value	df	Asymp. Sig. (2-sided)
Pearson Chi-Square	49.876[a]	18	.000
Likelihood Ratio	43.666	18	.001
Linear-by-Linear Association	15.127	1	.000
N of Valid Cases	148		

a. 20 cells (71.4%) have expected count less than 5. The minimum expected count is .20.

Fig 3.3

Testimi i Hipotezave të ngritura

Për të identifikuar dhe testuar hipotezat e ngritura në studim është ndërrmarë testi i korrelacionit për 3 variabla: Statusi i punësimit, Normat Shoqërore, Nxitësit Ekonomikë. Normat Shoqërore dhe Nxitësit ekonomikë janë shndërruar në variabla të rinj përmes llogaritjes së mesatares së pyetjeve me të cilat këto variabla janë matur**.**

Correlations

		7.Statusi juaj i punësimit	Normat_shoqerore	Nxitesit_ekonomike
7.Statusi juaj i punësimit	Pearson Correlation	1	-.184*	-.279**
	Sig. (2-tailed)		.027	.001
	N	148	144	144
Normat_shoqerore	Pearson Correlation	-.184*	1	.451**
	Sig. (2-tailed)	.027		.000
	N	144	145	144
Nxitesit_ekonomike	Pearson Correlation	-.279**	.451**	1
	Sig. (2-tailed)	.001	.000	
	N	144	144	145

*. Correlation is significant at the 0.05 level (2-tailed).

**. Correlation is significant at the 0.01 level (2-tailed).

Tabela3.4

Tabela tregon se ekziston një lidhje statistikisht e rëndësishme midis Statusit të punësimit dhe Normave Shoqërore (Pearson's R = -0.184, P value < 0.05). Megjithatë sipas rezultateve midis 2 variablave ekziston një marëdhënie e ulët negative prandaj mund të thuhet se H1 mbështetet. Normat shoqërore kanë një ndikim statistikisht të rëndësishëm në statusin e punësimit të grave në një nivel të ulët.

Së dyti tabela tregon se ekziston gjithashtu një marëdhënie negative në nivele të ulëta midis Statusit të Punësimit dhe Nxitësve ekonomikë si pagat e larta dhe niveli i të ardhurave (Pearson's R= - 0.2 P value< 0.01)

Bazuar në këto rezultate H2 e studimit refuzohet dhe pranohet hipoteza Null: Nxitësit ekonomikë nuk kanë një ndikim të rëndësishëm pozitiv në integrimin e grave në tregun e punës

Gjetjet e studimit tregojnë gjithashtu se faktorët që do motivonin më tepër pjesëmarrjen e grave në tregun e punës janë: trajtimi i barabartë i grave në vendin e punës (31.5%), paga të barabarta (30.82%) dhe së fundmi punë me orare fleksibël (25.34%). Edhe pse shumica prej pjesëmarrësve kanë zgjedhur këto alternativa disa prej tyre kanë preferuar dhe qasje më të lehtë në transportin publik (6.85%).



Grafiku 3.5

Përfundime

Gratë Shqiptare hasin një sërë barrierash të natyrës ekonomike, sociale e ligjore për tu përfshirë në tregun e punës si më poshtë:

- Mungesa e vendeve të punës është barriera më e hasur nga shumica e pjesëmarrësve të cilët raportojnë se mbajnë statusin e të papunë sepse nuk kanë mundur të gjejnë vende pune të lira
- Forma të ndryshme të diskriminimit dhe trajtimit të pabarabartë në punë përkeqësojnë në nivele të mëdha marëdhënien e grave me tregun e punës dhe i dekurajojnë ato të mos kërkojnë punë dhe të fokusohen më tepër në punët e shtëpisë.
- Perceptimi shoqëror mbi rolin e grave si kujdestare të fëmijëve dhe të prindërve të burrit vazhdon të prevalojë në kulturen shqiptare e për rrjedhojë të zgjerojë distancën midis tregut të punës dhe grave.
- Statusi civil ka një marëdhënie të ngushtë me Statusin e punësimit të grave megjithatë diferencat nuk janë midis grave beqare dhe atyre të martuara por midis këtyre të fundit dhe kategorive të tjera si Gra të divorcuara apo të Ve.
- Madhësia e familjes është një tjetër barrierë e identifikuar sipas së cilës sa më i madh numri i fëmijëve më i ulët integrimi i grave në tregun e punës

Studimi arriti të analizonte edhe ndikimin e Arsimit, Normave sociale dhe Nxitësve ekonomike në Integrimin e grave në tregun e punës. Në përfundim të të gjitha analizave të ndërrmara mund të thuhet se:

- Niveli arsimor i ndihmon gratë të përfshihen në tregun e punës. Sa më i lartë niveli arsimor aq më e madhe përfshirja e grave sidomos në sektorin publik. Megjithatë niveli

arsimor nuk konsiderohet si një barrierë e integrimit të grave në tregun e punës, përkundrazi si një faktor shtytës.

- Tiparet kulturore Maskiliste, Hierakike dhe Patriarkale pengojnë integrimin e grave në tregun e punës
- Martesa, partnerët dhe fëmijët ulin nivelin e përfshirjes së grave në tregun e punës
- Paga për jetesë (pranimi i ccdo pune pavarësisht pagës) shfaqet si një nxitës ekonomikë me ndikim në integrimin e grave në tregun e punës më tepër sesa pagat më të larta
- Qasja në transportin publik do të përmirësonte ndjeshëm integrimin e grave Shqiptare në tregun e punës.

Rekomandime

- Rishikimi i Ligjit aktual të Punës dhe rregulloreve. Rishikimi i rregulloreve aktuale dhe sugjerimi i ndryshimeve të mundshme për të mundësuar dhe lehtësuar krijimin e orareve fleksibile të punës dhe për të rritur përqindjen e detyrueshme të punësimit të grave në institucione publike dhe private.

- Të identifikohet si prioritet punesimi i grave në strategji dhe dokumenta të hartuara në kuadër të zhvillimit ekonomik. Norma sociale që gratë mbajnë përgjegjësinë kryesore për punët e shtëpisë dhe kujdesin ndaj fëmijëve mund të jetë një nga normat më sfiduese për të ndryshuar, por jo e pamundur.

- Të ofrohen skema të arsimimit dhe riaftësimit për gratë që janë të papunësuara për kohë të gjatë. Zyrat e punës mund të iniciojnë programe afatshkurtra të edukimit të përgjithshëm, si dhe trajnime profesionale intensive. Kjo do t'i pasurojë ato me aftësi të vlefshme, të cilat pastaj do tu japin optimizëm dhe besim atyre, veçanërisht për atë se punësimi i qëndrueshëm është i mundur përmes vet angazhimit të tyre aktiv.

- Mund të merret në konsideratë edhe ngritja e një portali interneti në bashkëpunim me Shërbimin Kombëtar të Punësimit. Kjo do të ofronte jo vetëm oferta për vende pune, por edhe tipe të ndryshme informacioni mbi aksesin në tregun e punës dhe perspektivat për karrierë për profesione të ndryshme.

- Njohja e punës së papaguar të grave në shtëpi. Ky rekomandim mbështetet edhe tek teoria e prodhimit shtëpiak, e cila konsideron se një pjesë e kohës së kaluar në shtëpi nuk përdoret vetëm si kohë e lirë, por përkundrazi për aktivitetet e prodhimit shtëpiak si gatimi, pastrimi dhe kujdesi për fëmijët.

- Nisur nga konstatimet e mësipërme se normat shoqërore kufizojnë aftësinë e grave për tu punësuar, atëherë rekomandoj programe që mundësojnë punën në shtëpi .Duke krijuar më shumë barazi në tregun e punës, kjo qasje mundet, nga ana tjetër, të gërryejë normat kufizuese dhe të promovojë punësimin e grave.

- Një qasje tjetër premtuese mund të jenë përpjekjet për të ndryshuar drejtpërdrejtë bindjet dhe qëndrimet e individëve dhe komunitetit, që privilegjojnë burrat në vendin e punës. Ndërsa kjo lloj ndërhyrjeje për ndryshimin e qëndrimeve përdoret shpesh nga organizatat joqeveritare, ekziston mundësia që të përqafohet edhe nga qeveritë, duke sjell një ndikim më të madh për shkak të pozitës së fuqishme që zotërojnë këto të fundit. Shumë vende duan të promovojnë barazinë gjinore, qoftë si një qëllim në vetvete, qoftë si një mënyrë për të rritur prosperitetin ekonomik. Fushatat mediatike dhe programe të vendosura në shkollë mund të jenë asete të vlefshme për të promovuar barazinë gjinore në punësim

- Fuqizim i OJF ndërkombëtare, kombëtare dhe lokale në kuadër të lobimit për mbështjetjen e grave në fushën e punësimit. Këto organizata do të mund të ndihmojnë grate duke ngritur më tepër zërin për barazi gjinore në tregun e punës, duke ofruar këshilla konstruktive, duke ofruar asistim të grave gjatë procesit të kërkimit të punës etj.

Bibliografia:

Adeyem, O. E., Odusina, K. E., & Akintoye, A. E. (2016). Religion and Labour Force Participation in Nigeria: Is there any Inequality among Women? African Journal of Reproductive Health / La Revue Africaine de La Santé Reproductive, 20(3), 75–84. https://www.jstor.org/stable/26357117

Bonnet, F., Vanek, J., & Chen, M. (2019, January). Women and men in the informal economy: A statistical brief. (2019, June 28). International Labour Office (ILO) and Women in Informal Employment: Globalizing and Organizing (WIEGO); ILOSTAT. (2020).

Bratti, M. (2003). Labour Force Participation and Marital Fertility of Italian Women: The Role of Education. Journal of Population Economics, 16(3), 525–554. http://www.jstor.org/stable/20007870

Cheng, Y. A., & Loichinger, E. (2017). The Future Labor Force of an Aging Taiwan: The Importance of Education and Female Labor Supply. Population Research and Policy Review, 36(3), 441–466. http://www.jstor.org/stable/26159817

Cotter, D. A., Hermsen, J. M., & Vanneman, R. (2001). Women's Work and Working Women: The Demand for Female Labor. Gender and Society, 15(3), 429–452. http://www.jstor.org/stable/3081892

Dang, H.H.& Nguyen, C.V. (2020, October). Gender inequality during the COVID-19 pandemic: Income, expenditure, savings, and job loss. IZA Institute of Labor Economics

Frank, K., & Hou, F. (2016). Beyond culture: source country female labour force participation and the earnings of immigrant women. Work, Employment & Society, 30(3), 410–435. https://www.jstor.org/stable/26499469

GASPARINI, L., & MARCHIONNI, M. (2017). Deceleration in Female Labor Force Participation in Latin America. Economía, 18(1), 197–224. https://www.jstor.org/stable/90017439

Göksel, İdil (2010). Determinants of school attainment in Turkey and the impact of the extension of compulsory education. In Egypt National Child Rights Observatory (ENCRO) (Ed.), Child Poverty and Disparities: Public Policies for Social Justice, Egypt National Child Rights Observatory

Gumus, S. (2014). The effects of community factors on school participation in Turkey: A multilevel analysis. International Review of Education / Internationale Zeitschrift Für Erziehungswissenschaft / Revue Internationale de l'Education, 60(1), 79–98. http://www.jstor.org/stable/24637254

Hadjar, A., & Buchmann, C. (2016). Education systems and gender inequalities in educational attainment. In A. Hadjar & C. Gross (Eds.), Education systems and inequalities: International comparisons (1st ed., pp. 159–184). Bristol University Press. https://doi.org/10.2307/j.ctt1t892m0.14

Hosney, Sara Hassan (2016): Factors influencing female labor force participation in Egypt and Germany: A comparative http://hdl.handle.net/10419/130586

Jayachandran, S. (2015). The Roots of Gender Inequality in Developing Countries. Annual Review of Economics, 7, 63–88. http://www.jstor.org/stable/44860742

Jick, T. D. (1979). Mixing Qualitative and Quantitative Methods: Triangulation in Action. Administrative Science Quarterly, 24(4), 602–611. https://doi.org/10.2307/2392366

Johnson, R. B., & Onwuegbuzie, A. J. (2004). Mixed Methods Research: A Research Paradigm Whose Time Has Come. Educational Researcher, 33(7), 14–26. http://www.jstor.org/stable/3700093

Lincove, J. A. (2008). Growth, Girls' Education, and Female Labor: A Longitudinal Analysis. The Journal of Developing Areas, 41(2), 45–68. http://www.jstor.org/stable/40376175

Norton, S. W., & Tomal, A. (2009). Religion and Female Educational Attainment. Journal of Money, Credit and Banking, 41(5), 961–986. http://www.jstor.org/stable/40271588

SPERLING, G. B., WINTHROP, R., KWAUK, C., & YOUSAFZAI, M. (2016). The World's Best Investment: Girls' Education. In What Works in Girls' Education: Evidence for the World's Best Investment (pp. 15–62). Brookings Institution Press. http://www.jstor.org/stable/10.7864/j.ctt17w8hh8.

Shtojcë

Pyetësor

Përshëndetje,

Ju ftoj të bëheni bashkëpunëtor, duke plotësuar pyetësorin e mëposhtëm, i cili zhvillohet në kuadër të studimit mbi problemet e punësimit të grave në Shqipëri. Ju siguroj se të dhënat do të mbeten konfidenciale dhe do të përdoren vetëm për qëllime studimi, ndaj mos lini asnjë pyetje të paplotësuar dhe ju lutem të përgjigjeni me sinqeritet!

Seksioni 1- Të dhëna demografike

1. Zona ku jetoni
   a) Rurale
   b) Urbane

2.Mosha juaj është:

   a) 23-38
   b) 29-35
   c) 36-40
   d) Mbi 41 vjece

3.Niveli juaj arsimor:

   a) Pa arsim
   b) Shkollë fillore
   c) Shkollë nëntëvjeçare
   d) Shkollë e mesme
   e) Universitet
   f) Master
   g) Doktoraturë

4.Statusi civil

   a) Beqare
   b) I/e martuar
   c) I/e divorcuar
   d) I/e ve
   e) Bashkëjeton

5. Cili është pozicioni juaj në familje?

   a) Kryefamiljare
   b) Bashkeshorte
   c) Bijë
   d) Tjetër

6. A keni fëmijë

   a) Po
   b) Jo

7. Nese po, sa femije keni

   a) 1
   b) 2
   c) 3
   d) Më shumë se 3

8. Statusi juaj i punesimit

a) Punoj në sektorin publik
b) Punoj ne sektorin privat
c) Jam e vetpunësuar
d) E papune

9. Nëse jeni e punësuar, mund të na thoni se sa e vështirë ka qenë për ju punësimi?
a) Aspak e vështirë
b) Deri diku e vështirë
c) Neutral
d) E vështirë
e) Shumë e vështirë

10. Nese keni zgjedhur alternative e papune, Prej sa muajësh, vitesh jeni e papunë?
a) Më pak se 3 muaj
b) Më pak se 6 muaj
c) Më pak se 1 vit
d) Më pak se 2 vjet
e) Më pak se 5 vjet
f) Nuk kam punuar asnjëherë

Seksioni 2;

11.Cili është shkaku kryesorë i papunësisë suaj

a) Nuk kam mundur të gjej punë
b) Nuk dua të punoj
c) Bashkëshorti/partneri nuk do që unë të punoj
d) E kam të vështirë të kombinoj punën me punët e shtëpisë
e) Diskriminimi
f) Pandemia globale Covid 19
g) Tjetër

12. A keni kërkuar për punë në tri vitet e fundit?

a) Jo
b) Po në sektorin publik
c) Po në sektorin privat
d) Po edhe në sektorin publik, edhe atë privat

13. Nese jo, perse
a) Kam pasur angazhime ne familje
b) Kam qene duke ndjekur studimet
c) Kam pasur probleme shendetesore
d) Nuk kam pasur nevoje
e) Tjeter

14. Cilat mendoni se janë arsyet kryesore pse gratë nuk kërkojnë punë?

a) Kujdesen për fëmijët dhe anëtarët e tjerë të familjes
b) Nuk ka punë në dispozicion
c) Janë të shkolluara në fushat/profilet ku kërkesa për punëtorë është e vogël
d) Gratë i kanë mundësitë më të vogla për punësim, në krahasim me burrat
e) Mungesa Arsimimit
f) Tjeter

15. Ju lutem zgjdhni alternativen me te cilen jeni dakord nga 1 deri në 5. (1=Aspak dakord, 5=Shumë dakord)
    a) Pagat më të larta i inkurajojnë gratë të bashkohen me fuqinë punëtore, veçanërisht nëse ekzistojnë punë të përshtatshme.
    b) Mungesa e arsimit I pengon grate te integrohen ne tregun formal te punes
    c) Grate perballen me veshtiresi per tu punesuar sepse nuk ofrohen mjaftueshem kurse profesionale
    d) Grate me arsim te larte mund te integrohen me shpejt ne tregun e punes sesa ato me arsim te mesem
    e) Grate me arsim te larte mund te punesohen ne nivele te larta menaxheriale
16. Nëse do të punësoheshit cilët nga faktorët e mëposhtëm mendoni se do tju pengonin të merrnit përgjegjësi të reja në punë
    a) Niveli i ulët i edukimit
    b) Mangësia e vendeve të punës
    c) Mangësia e trajnimeve sesi të ngrihem në detyrë
    d) Kufizimet që unë kam nga anëtarët e familjes
    e) Tjetër
17. Burimet e të ardhurave në familjen tuaj vijnë nga:
    a) Partneri/Bashkëshorti
    b) Djali Vajza
    c) BabaiNëna
    d) Vëllai Motra
    e) Të afërm
    f) I siguroj vetë të ardhurat
18. Si e vlerësoni nivelin e të ardhurave tuaja familjare

    a) Ne mund të përballojmë vetëm blerjen e ushqimeve
    b) Kemi para të mjaftueshme për të blerë ushqime dhe rroba
    c) Kemi para të mjaftueshme për të blerë ushqime, rroba dhe orendi shtëpiake
    d) Kemi para të mjaftueshme për të blerë ushqime, rroba dhe orendi shtëpiake, si dhe për të shkuar me pushime
    e) Kemi para të mjaftueshme për të bërë blerje të mëdha, si blerja e një shtëpie dhe/ose automjeti
    f) Asnje nga te mesipermet
19. Në kuadrin afatmesëm dhe afatgjatë, duke mbajtur parasysh avantazhet dhe disavantazhet (ekonomike, personale, njohjet sociale, qëndrueshmërinë e punës, e kështu me rradhë), tregoni nivelin tuaj të tërheqjes kundrejt secilit nga opsionet profesionale të mëposhtme.

(Nga 1- tërheqje minimale në 7 -tërheqje maksimale)

    a) Punë e paguar 1 2 3 4 5 6 7
    b) Profesion i lirë 1 2 3 4 5 6 7
    c) Sipërmarrëse 1 2 3 4 5 6 7
20. Sa dakord jeni me pohimet e meposhtme ne nja shkalle nga 1 deri ne 5

    a. Grate ne Shqiperi jane te papuna sepse prinderit nuk i kane ndihmuar te arsimohen
    b. Grate ne Shqiperi jane te papuna sepse bashkeshortet/partneret nuk i lejojne te punojne
    c. Martesa pengon punesimin e grave sepse sepse burrat që janë rritur në një familje konservatore janë mësuar se gratë duhet të punojnë vetëm në shtëpi dhe sillen në të njëjtën mënyrë me bashkëshortet e tyre
    d. Grate ne Shqiperi përjashtohen nga tregu i punës sepse paguhen me pak se sa meritojne

e. Grate në Shqipëri janë të papuna sepse meshkujt favorizohen më tepër në pozicione vakante

21. Në qoftë se vendosni të krijoni një firmë/biznes tuajin, personat në rrethin tuaj të ngushtë a do ta aprovonin këtë vendim? (Nga 1-plotësisht jo dakord në 7 -plotësisht dakord)

a) Familjarët e afërt 1 2 3 4 5 6 7
b) Rrethi shoqëror 1 2 3 4 5 6 7
c) Persona të tjerë të rëndësishëm për ju 1 2 3 4 5 6 7

22. Cilët janë faktorët që do të motivonin dhe do tu mundësonin grave të bëhen aktive në tregun e punës?

a) Paga të barabarta për përgjegjësi
b) Trajtim I barabartë në vendin e punës
c) Puna me orar të shkurtuar fleksibël
d) Qasja e lehtë në transportin publik
e) Qasja në cerdhe për kujdes të fëmijëve
f) Tjetër

23.Cfarë do të sugjeronit për rritjen e pjesëmarrjes së grave dhe vajzave në tregun e punës

a) Rritja e mundësive për trajnime dhe kualifikim
b) Krijimi i mundësive të përkujdesit për fëmijët në komunitete, si kopshte dhe çerdhe
c) Nxitja e punësimit të grave në institucionet e nivelit vendor dhe qendror
d) Rritja e ndihmesës së burrave në shtëpi
e) Krijimi i shtysave për gratë për të hapur bizneset e tyre
f) Krijimi i mundësive që gratë të punojnë nga shtëpia
g) Tjetër

Faleminderit

Gjithë të mirat!